



KUVENDI I KOSOVËS DORACAK MBI DËGJIMIN PUBLIK

Ky doracak është përgatitur nga Dr. Sherrie Wolf për NDI - Kosovë në bashkëpunim me “Iniciativën për Përkrahjen e Kuvendit”.

Materialet shtesë janë siguruar nga Kevin Deveaux, i cili ka punuar në procesin e revidimit të këtij materiali.

Individët tjerë të cilët ofruan sugjerimet, idetë dhe përkrahjen e tyre janë paraqitur në vazhdim: Catherine Cornish, Elvis Zutic, Heather Kashner, Edmond Efendija, Uli Steinle dhe Franklin De Vrieez. Dëshirojmë të falenderojmë këta njerëz si dhe gjithë të tjerët të cilët dhanë kohën dhe energjinë e tyre për kompletimin e këtij doracaku.



Publikimi i këtij doracaku është bërë i mundshëm -nëpërmjet përkrahjes nga ana e Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar/ Prishtinë, në bazë të marrëveshjes për bashkëpunim Nr. 167-A-00-04-00101-00. Mendimet e shprehura mëtutje i takojnë NDI-së dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e Agjencionit të SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar.

Përgatitur nga Instituti Kombëtar Demokratik - Kosovë

Rruga Prizrenit 10

Prishtinë - 38000 Kosovë

+381.38 244.994

Prishtinë 2004

PËRMBAJTJA

<i>I. DËGJIMET PUBLIKE SI PJESË PËRBËRËSE E PUNËS SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE</i>	4
<i>II. LLOJET E DËGJIMEVE PUBLIKE</i>	5
<i>Dëgjimet Publike Legjislative</i>	5
<i>Dëgjimet publike mbikëqyrëse</i>	5
<i>Dëgjimet publike hetimore</i>	5
<i>Zhvillimi i dëgjimeve publike në terren</i>	6
<i>III. PËRGATITJA DHE ZHVILLIMI I DËGJIMEVE PUBLIKE</i>	7
<i>Burimet e ndihmës nga jashtë</i>	7
<i>Dëgjimet e përbashkëta publike</i>	8
<i>IV. PËRGATITJA E DËGJIMIT PUBLIK</i>	9
<i>Anëtarët e Komisionit - Përgjegjësitë</i>	9
<i>Përgjegjësitë e personelit të Komisionit</i>	10
<i>SHTOJCË # 1:</i>	
<i>MOSTËR PYETJESH NGA DËGJIMI PUBLIK MBI LIGJIN KUNDËR DISKRIMINIMIT DHE LIGJIT PËR BARAZI GJINORE</i>	14
<i>MOSTËR PYETJESH NGA NJË DËGJIM PUBLIK I SIMULUAR MBI NJË LIGJ TË PARAMENDUAR MBI TATIMIN MBI PRONËN E PALUAJTSHME</i>	16
<i>SHTOJCË # 2:</i>	
<i>ORARI I PARASHIKUAR PËR PËRGATITJEN E DËGJIMEVE PUBLIKE</i>	19
<i>PAS DËGJIIMT</i>	20

I. DËGJIMET PUBLIKE SI PJESË PËRBËRËSE E PUNËS SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE

Dëgjimi publik mund të përkufizohet si mekanizëm për mbledhjen e informatave që shfrytëzohet nga komisionet parlamentare gjatë shqyrtimit të politikave dhe mbikqyrjes së punës së qeverisë. Dëgjimet publike mund të mbahen në lidhje me çështjet, siç janë: mungesa e kornizave ligjore, edhe pse rëndom dëgjimet publike organizohen lidhur me projektligjet dhe propozimet për ligje të reja. Sidoqoftë, parlamentet kanë dobi të shumta nga dëgjimet publike.

Dëgjimet publike i informojnë anëtarët e parlamentit, personelin e departamenteve të ndryshme dhe publikun mbi çështjet e ndryshme të shqyrtuara në një projekt ose propozim të veçantë, mbi masat që duhet të ndërmerren me qëllim të përmirësimit të aktit ligjor dhe përcaktojnë intenzitetin e përkrahjes për një ligj të veçantë.

Poashtu dëgjimet publike kanë për qëllim të përcjellin nivelin e zbatimit të programit të punës nga ana e qeverisë, t'i monitorojnë veprimtaritë e qeverisë dhe të prezantojnë problemet e një fushe të dhënë, me të cilat Kuvendi i Kosovës mund të merret më vonë.

Edhe pse qeveria mban tryeza të rrumbullakëta dhe dëgjime publike gjatë përpilimit të një legjislacioni, dëgjimet publike nëpër komisione parlamentare nuk janë përsëritje. Kjo u jep komisioneve mundësi që të ftojnë ekspertët të cilët nuk janë dëgjuar, zgjerojnë listën e pyetjeve si dhe t'i parashirojnë pyetje qeverisë. Komisionet nuk duhet të mbështeten kryekëput në informatat e ofruara dhe me gjasë filtruara nga qeveria.

Dëgjimet publike i mundësojnë qytetarëve të marrin pjesë në formimin e qëndrimeve për çështje të caktuara, duke ndihmuar kështu në krijimin e opinionit publik mbi një masë që duhet ndërmarrë apo çështje të caktuara.

II. LLOJET E DËGJIMEVE PUBLIKE

Të gjitha llojet e dëgjimve publike përbajnë elementet e njëjta të përgatitjes dhe zhvillimit të tij. Disa prej tyre parashikohen me rregulloren ekzistuese të punës së Kuvendit. Por njëkohësisht, për arsye të ndryshme, ekzistojnë edhe dallime ndërmjet llojeve të ndryshme të dëgjimeve publike.

Është e zakonshme për secilin trup punues që të përgatisin dhe të miratojnë rregulloren e tyre të punës. Këto rregullore duhet të jenë në pajtim e Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës, mirëpo gjithashtu mund të zgjerojnë dhe shtjellojnë dispozitat të cilat përmbahen në to.

Dëgjimet publike mbahen për qëllime të ndryshme. Varësisht nga qëllimi, dëgjimet publike mund të ndahen në tri kategori kryesore:

- legjislative
- mbikëqyrëse
- hetimore

Nganjëherë dëgjimi publik mund të shërbejë për dy qëllime, si për shembull për qëllime legjislative dhe mbikëqyrëse. Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës parashikon disa detaje se si duhet të zhvillohen këto tri lloje të dëgjimeve publike.

Komisionet parlamentare zhvillojnë **dëgjime publike legjislative** për çështjet dhe problemet që kanë të bëjnë me projektligjet e veçanta, ose me qëllim të promovimit të mundësive të cilat më vonë mund të bëhen projektligje. Në Kuvendin e Kosovës këtë mandat e kanë komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

Komisionet parlamentare mund të mbajnë dëgjime publike për të adresuar një çështje e cila mund të jetë projektligj apo e cila kërkon ndonjë lloj veprimi nga ana e qeverisë. Gjithashtu, und të caktohet një komision për të shqyrtuar një projektligj si pjesë e procesit legjislativ të shqyrtimit të ligjit para miratimit të tij si një akt ligjor.

Dëgjimet publike mbikëqyrëse shqyrtojnë një akt, çështje apo problem, ose ndonjë aktivitet të propozuar, më së shpeshti duke u përqëndruar në cilësinë e programeve qeveritare dhe nivelin e kryerjes së detyrave nga ana e zyrtarëve të qeverisë. Mandati i një komisioni të tillë parashikohet me rregullën 44 të rregullores së punës së kuvendit.

Dëgjimi publik mbikëqyrës gjithashtu siguron që zbatimin e ligjit nga ana e degës së ekzekutivit të bëhet në pajtim me qëllimin e ligjvënësit dhe që politika administrative të pasqyrojë interesin publik. Qëllimi i një dëgjimi publik të këtillë është të avansojë aktivitetet efikase dhe ekonomike qeveritare. Është e zakonshme që komisionet parlamentare të bajnë dëgjime publike të tilla gjatë riautorizimit ose miratimit të programeve të reja ose themelimit të agjencive qeveritare.

Dëgjimet publike hetimore kanë disa veçori të përbashkëta me dëgjimet legjislative dhe mbikëqyrëse. Dallimi qëndron në vetë natyrën hetimore, zakonisht nëse ka dyshime se

është kryer shkelje nga një zyrtar publik gjatë ushtrimit të funksionit zyrtar ose në rastet kur një kompani apo individ dyshohet se ka kryer shkelje të këtillë.

Rregulla 39. e Rregullores së Punës i jep të drejtë vetëm Kuvendit që të themelojë një komision hetimor i cili i posedon të gjitha të drejtat e një komisioni funksional por edhe të drejtën për të detyruar dëshmitarët që të marrin pjesë dhe dëshmojnë në seancat e tilla dëgjimore.

Zhvillimi i dëgjimeve publike në terren

Shumica e dëgjimve publike mbahen në selinë e parlamentit, por trupi punues mund të vendosë sipas nevojës që dëgjimi publik të mbahet diku tjetër. Ekzistojnë disa arsye për organizimin e dëgjimve publike në terren. Dëgjimi publik e afron parlamentin me njerëzit. Nëpërmjet dëgjimeve publike në terren, komisioni parlamentar mund t'i dëgjojë dëshmitarët, të cilët nuk janë në gjendje të vijnë në selinë e parlamentit për të dëshmuar. Në këtë mënyrë, njerëzit të cilët janë të prekur drejtpërdrejtë nga një çështje apo problem mund të marrin pjesë në një dëgjim të tillë publik.

Është me rëndësi të ceket se gjatë vizitave në terren komisioni në fjalë vetëm mbledhë dhe shkëmben informata. Në terren nuk mbahen kurrfarë mbledhje të rregullta ku komisioni merr vendime me karakter obligativ. Vizitat të cilat komisioni do t'i zhvillojë në terren realizohen vetëm në raste përjashtimore, edhe pse anëtarët individual të komisionit janë të lirë të vizitojnë çfarëdo institucioni me qëllim të mbledhjes së informatave për qëllime personale.

III. PËRGATITJA DHE ZHVILLIMI I DËGJIMEVE PUBLIKE

Kur të vendoset për mbajtjen e një dëgjimi publik, komisionet parlamentare duhet të marrin parasysh çështje të ndryshme. Komisioni duhet të përkufizojë llojin e informatës të cilën dëshiron t'a merr përmes dëgjimit dhe mëpastaj të shqyrtojë se a është dëgjimi publik metoda më e mirë për realizimin e qëllimeve specifike të komisionit parlamentar. Në planifikimin e dëgjimit publik do të kenë ndikim disa faktorë, përfshirë këtu rëndësinë e çështjes së parashtruar, nivelit të interesimit të grupeve të ndryshme në çështjen e parashtruar dhe rëndësinë që ka dëgjimi publik për vetë parlamentin. Komisionet parlamentare në tërë botën shpesh pranojnë me mijëra kërkesa për dëgjime publike. Në rast të numrit të madh të kërkesave të parashtruara, komisionet duhet të vendosin se a do të ishte një gjë e duhur mbajtja e një dëgjimi publik mbi temën e caktuar. Kjo bazohet në fushëveprimin dhe mandatin e parashikuar në shtojcën e Rregullores së Punës së Kuvendit. Komisioni duhet gjithashtu të merr parasysh nëse mbajtja e dëgjimit do të bëhet në pajtim me shfrytëzimin më të mirë të fondeve dhe personelit. Së fundi, komisioni duhet të merr parasysh se a përshtatet dëgjimi publik me planin e përgjithshëm të punës së komisionit.

Me qëllim të marrjes së pëlqimit për dëgjim publik, kordinatori i komisionit duhet të përgatisë një shënim paraprak mbi dëgjimin publik për kryetarin e komisionit që do të përmbante informatën lidhur me qëllimin dhe fushëveprimin e dëgjimit publik, rezultatet e pritura, listën e dëshmitarëve të mundshëm, numrin e ditëve të nevojshme për dëgjimin publik dhe sipas mundësisë edhe qëndrimet e grupeve parlamentare. Krahas kësaj, mund të jetë e dobishme edhe një përmbledhje e shkurtër me shkrim nga bisedat jozyrtare me anëtarët e Komisionit.

Burimet e ndihmës nga jashtë

Për komisionet parlamentare janë në dispozicion një sërë burimesh qeveritare dhe joqeveritare, për t'iu ndihmuar në mbajtjen e dëgjimeve publike, meqë shumica e dëgjimeve publike përqëndrohen në programet qeveritare apo programet e mundshme. Prandaj agjencitë ekzekutive shpesh mund të jenë burimi më i mirë i informacionit. Komisionet mund të kërkojnë informata drejtpërdrejtë nga zyret e qeverisë. Nëse një ministri e qeverisë nuk ofron informata atëherë komisioni ka pushtet në bazë të Rregullës 44. (2)(c) të detyrojë ministrin apo stafin e tij që të merr pjesë dhe dëshmojë para komisionit.

Organizatat joqeveritare mund të jenë burim i pasur i informatave për komisionet parlamentare. Bota akademike dhe personeli nga organizatat tjera shpesh janë të gatshëm të ofrojnë ndihmë me anë të prezentimit të të dhënave specifike, analizave dhe deklaratave. Studimet kanë treguar se dhënia e dëshmisë para komisionit parlamentar gjatë seancës publike është një metodë e rëndësishme dhe efikase për amandamentimin e legjislacionit. Përveç kësaj, procesi i konsultimit me ekspertë dhe grupet e interesit iu siguron informata dhe ndihmë komisioneve nga qytetarët e rëndomtë, të cilët kanë përvoja të drejtpërdrejta në lidhje me ligjin apo çështjen e propozuar dhe të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikohen nga vendimet e nxjerrura nga komisioni dhe parlamenti.

Dëgjimet publike të përbashkëta

Nganjëherë është e dobishme të shqyrtohet mbajtja e dëgjimeve publike së bashku me ndonjë komision tjetër. Në raste të tilla, të dyja komisionet duhet të pajtohen për rregullat e punës dhe duhet të marrin parasysh çështjet logjistike siç është vendi i mbajtjes. Nëse dy apo më shumë komisione dëshirojnë të mbajnë një dëgjim publik në të njëjtën temë apo projektligj, ata duhet të mbajnë një mbledhje të përbashkët për të vendosur mbi datën dhe procedurën e mbajtjes së dëgjimit të përbashkët.

Vendimi mbi dëgjimet publike të përbashkëta me gjasë mund të pranohet më mirë nga parlamenti në rend të parë për shkak të faktit se kjo mënyrë e punës është mënyra më efektive e shfrytëzimit të mjeteve të kufizuara financiare që janë në dispozicion për këtë lloj aktiviteti. Organizimi i dëgjimeve të përbashkëta mund t'i zvogëlojë vështirësitë dhe vonesat që mund të paraqiten ndonjëherë nga veprimet dhe propozimet kundërthënëse të komisioneve.

Megjithatë në shumicën e parlamenteve në botë dëgjimet e tilla nuk janë të shpeshta. Disa legjislatura mendojnë se parlamenti do të përfitonte më shumë nga prezantimi i ndarë i pikëpamjeve dhe qasjeve nga ana e komisioneve parlamentare. Për më tepër, koordinimi ndërmjet dy komisioneve do të pengojë nga fakti se ekzistojnë dinamika të ndryshme sa i përket mbajtjes së mbledhjeve të komisioneve, gjë që ndikon drejtpërdrejt në oraret e anëtarëve individual të komisionit.

IV. PËRGATITJA PËR DËGJIM PUBLIK

Anëtarët e komisionit - përgjegjësitë

- A. Nëse do të mbahet dëgjimi publik lidhur me një projektligj apo çështje specifike, atëherë për kohën dhe temën e dëgjimit publik duhet të vendosin anëtarët e komisionit dhe atë së paku dy javë para ditës së mbajtjes së dëgjimit publik në mënyrë që t'u mundësohet anëtarëve të komisionit të njihen me çështjen, t'i mundësohet personelit përgatitja adekuate si dhe t'u mundësohet dëshmitarëve kohë për ta përgatitur dëshminë e tyre. (Shih mostrën e kalendarit në shtojcën nr.2).
- B. Anëtarët duhet të vendosin se cilin lloj të dëshmitarëve dëshirojnë t'i kenë si pjesëmarrës, duke siguruar përfaqësimin nga të gjitha anët e asaj çështje. Dëshmitarët duhet të përfshijnë ekspertët akademik, përfaqësuesit e ministrive të qeverisë, njerëzit e përfshirë në udhëheqjen e biznesit apo çështjes e cila do të shqyrtohet, OJQ-të e interesuara për atë lëmi si dhe persona të tjerë të cilët mund të posedojnë informata thelbësore për atë çështje. Gjithashtu edhe përfaqësuesit e UNMIK-ut do të thirren për të dhënë mendimin e tyre dhe të sigurojnë integritimin e shqetësimeve të tyre para nxjerrjes së ligjit përkatës. Një kohë adekuate duhet gjithsesi të ndahet edhe për dëshmitarët që kundërshtojnë projektligjin apo çështjen që shtjellohet. Panelet duhet të përbëhen nga të gjithë përfaqësuesit e të njëjtit komunitet të organizatave. Për shembull, një panel duhet të përbëhet nga ekspertët akademikë, përfshirë këtu edhe ekspertët nga ministritë përkatëse; përderisa paneli tjetër mund të përbëhet nga përfaqësuesit e OJQ-ve, ndërsa tjetri nga grupet e interesit të fushës së biznesit etj. Çdo grup politik duhet të ketë të drejtë të nominojë dëshmitarët e vet në bazë të përfaqësimit të tyre, nëse nuk arrihet vendim unanim mbi listën e dëshmitarëve që duhet ftuar.
- C. Komisioni duhet të përgatitë një listë të pyetjeve të cilat i dorëzohen dëshmitarëve së bashku me thirrjen për të marrë pjesë në dëgjimin publik (shih shtojcën nr.1). Këto pyetje i ndihmojnë dëshmitarëve për të përgatitur dhe strukturuar deklaratat e tyre në mënyrë që ato të adresojnë problemet specifike. Këto pyetje janë vetëm udhëzime dhe nuk kanë karakter obligativ qoftë për dëshmitarët gjatë dhënies së deklaratave qoftë për pyetjet gojore të cilat anëtarët e komisionit i parashtrajnë gjatë dëgjimit publik.
- D. Anëtarët duhet të vendosin mbi kohëzgjatjen e prezenteve të dëshmitarëve. Kufizimet kohore duhet të përcaktohen në mënyrë që të përjashtohet mundësia e dominimit të kohës nga ndonjë dëshmitar. Dëshmitarët në çdo kohë mund t'i ofrojnë komisionit dokumentacionin mbi idetë dhe punën e tyre për qëllime të vlerësimit, mirëpo një material i tillë me shkrim do të ishte i dobishëm nëse shfrytëzohet para dhënies së deklaratës gojore. Shpeshherë koha për prezantim është e kufizuar prej 5 deri në 10 minuta për një dëshmitar dhe 5 deri në 10 minuta të tjerë të dedikuar për pyetje dhe përgjegje nga anëtarët e komisionit.
- E. Gjatë Shqyrtimit të Parë anëtarët e komisionit duhet të mbajnë shënime të sakta të pyetjeve dhe komenteve të cilat janë bërë lidhur me projektligjin të cilin ata do t'a shqyrtojnë, në mënyrë që të adresojnë në mënyrë të duhur shqetësimet e deputetëve të tjerë.
- F. Anëtarët e komisionit duhet të shfrytëzojnë tërë kohën e tyre në dispozicion para mbajtjes së dëgjimit publik për t'u informuar mbi çështjen e cila është temë e diskutimit. Personeli ndihmës duhet të sigurojë materialin informativ për anëtarët e komisionit.

Personeli i komisionit - përgjegjësitë

A. Me vendimin e komisionit për të mbajtur dëgjimin publik, personeli duhet të gjejë lokacionin dhe të aranzhojë një dhomë adekuate për dëgjimin publik. Personeli duhet të sigurojë që:

1. Dhoma është në dispozicion ditën e caktuar më parë nga komisioni;
2. Dhoma është mjaft e gjërë për të pranuar të gjithë pjesëmarrësit që pritet të vijnë në dëgjim;
3. Dhoma është e pajisur me tavolina dhe mikrofonë adekuat për 15-20 persona në të njëjtën kohë;
4. Dhoma ka karriga të mjaftueshme për vëzhguesit;
5. Dhoma ka vend për përkthyesit dhe përfaqësuesit e mediave;
6. Personeli dhe pajisjet për realizimin e transkriptit të dëgjimit do të jenë aty;
7. Dhoma është në dispozicion së paku një orë para dëgjimit në mënyrë që të mundësohet rregullimi dhe organizimi i hapsirës si dhe së paku një gjysëm ore pas përfundimit të dëgjimit.

B. Sigurohen përkthyesit dhe pajisjet për përkthim

C. Dërgohen ftesat, agjenda dhe pyetjet dëshmitarëve të propozuar nga komisioni. Ftesat duhet të dërgohen së paku një javë para dëgjimit dhe thirrjet për konfirmim duhet të bëhen pas dëgjimit të ftesave. Në ftesë duhet të shënohet edhe koha, e caktuar nga komisioni, të cilën e kanë në dispozicion dëshmitarët për ta prezentuar dëshminë e tyre. Gjithashtu në ftesë duhet të ceket se dëshmitarët janë të inkurajuar që t'i paraqesin me shkrim komentet e tyre plotësuese.

D. Pas konfirmimit të pjesëmarrjes së tyre, dëshmitarët duhet të njoftohen për kohën e dedikuar për paraqitjen e prezantimeve të tyre duke potencuar se komentet me shkrim mund të dorëzohen për shqyrtim nga komisioni pas dëgjimit.

E. Përgatitet agjenda e dëgjimit publik. Përfshini në agjendë emrin e komisionit, titullin e projektligjit apo temës e cila duhet të shqyrtohet, datën, kohën dhe vendin e dëgjimit, si dhe emrat dhe kohën e përafërt kur duhet secili dëshmitar të paraqitet gjatë seancës.

F. Sigurohet transporti dhe sigurimi për deputetët serb të cilët marrin pjesë në seancë.

G. Tregoni punëtorëve të sigurimit sa më parë që është e mundur për datën, kohën dhe vendin e dëgjimit si dhe faktin që është publike. Siguroni listën e dëshmitarëve për punëtorët e sigurimit dhe diskutoni me ta se si dëshmitarët do të jenë në gjendje të hyjnë në ndërtesë.

H. Përgatitni deklaratën për shtyp që t'ua shpërndani mediave para dëgjimit publik si dhe një deklaratë më të kompletuar për shtyp dhe një pako për shtyp të cilën do t'ua shpërndani përfaqësuesve të mediave në ditën e dëgjimit. Sektori për Media dhe Marrëdhënie me Publikun në konsultim me kryesuesin e komisionit duhet të lëshoj komunikatë për shtyp, deklaratë për shtyp dhe të përgatisë pakon për shtyp. Pakoja në fjalë duhet të përfshijë:

1. Vendin;
2. Rendin e ditës së dëgjimit;
3. Një listë të anëtarëve të Komisionit;

4. Listën e dëshmitarëve;
 5. Deklaratat me shkrim të dëshmitarëve, nëse janë dorëzuar ato;
 6. Përmbledhjen e projektligjit;
 7. Kodin e mirësjelljes për mediat në Kuvend;
- I. Përgatitni materialet informative për anëtarët e komisionit. Dokumentet apo libri informativ duhet të përmbajë:
1. Informatat lidhur me projektligjin apo çështjen;
 2. Informatat përkatëse për buxhetin, për atë se si do të ndikojë projektligji në skemën buxhetore dhe ku do të sigurohen fondet;
 3. Mbulimin nga shtypi në lidhje me ligjin apo çështjen përkatëse;
 4. Listën e pyetjeve për anëtarët;
 5. Informata për sfondin e dëshmitarëve;
 6. Fleta të bardha në të cilat mund të shkruajnë deputetët.

J. Gjërat specifike të cilat nevoiten për tu përgatitur

1. Përgatitni dhe dërgoni shënimet për udhëheqjen e dëgjimit për kryesuesin e komisionit.
2. Përgatitni një lajmërim **për t'a vendosur në derën ku mbahet seanca**. Ky lajmërim duhet të përmbajë emrin e komisionit, kohën dhe qëllimin e mbajtjes së dëgjimit dhe informatat se pjesëtarët e publikut janë të mirësearchur të marrin pjesë gjatë dëgjimit.
3. Bëni kopje rezervë të dokumenteve në vijim dhe merrini në dëgjimin publik:
 - a.) Projektligjin;
 - b.) Listën e antarëve të komisionit;
 - c.) Agjendën dëgjimit publik;
 - d.) Kopje shtesë të deklaratave të dëshmitarëve;
 - e.) Komunikatën për shtyp;
 - f.) Letër të bardhe dhe markera që nëseparaqitet nevoja të bëni më shumë pllakëza të emrave;
 - g.) Shënimet e kryesuesit të komisionit për kryesuesin dhe dokumentet informative për anëtarët e komisionit. *(Mos lejoni që këto dokumente t'i shoh askush tjetër përveç kryesuesit dhe anëtarëve të komisionit. Këto dokumente nuk janë publike).*

Secili anëtar i personelit të komisionit duhet gjithashtu të merr me vete gjatë dëgjimit publik një kopje të Rregullores së Punës, dokumentet informative, projektligjin, letër të bardhë për shënime, stilograf etj, si dhe listën me emrat e dëshmitarëve dhe numrat e tyre të telefonit në mënyrë që të mund t'i kontaktojnë nëse paraqitet nevoja.

K. Gjërat që duhet të bëhen para ditës së dëgjimit:

1. Verifikoni nëse dhoma për dëgjim është në dispozicion, dhe atë në kohën e duhur.
2. Verifikoni çështjen e sigurimit të përkthyesve dhe pajisjeve të përkthimit.
3. Një ditë para dëgjimit telefononi secilin anëtar të komisionit dhe konfirmoni pjesëmarrjen e tyre dhe se e dijnë kur dhe ku do të mbahet dëgjimi.
4. Telefononi dëshmitarët dhe konfirmoni pjesëmarrjen e tyre, informoni për kohën e dëgjimit si dhe kufizimet e caktuara nga ana e komisionit. Kërkoni nga ata që t'i sigurojnë personelit komentet e tyre me shkrim paraprakisht në mënyrë që personeli të ketë kohë të mjaftueshme për t'i fotokopjuar dhe shpërndarë anëtarëve në kuadër të librave për informim të tyre. Kjo gjithashtu do t'i ofrojë mundësi anëtarëve që formësojnë pyetjet shtesë të bazuara në dëshminë e përgatitur.
5. Gjithashtu konfirmoni se shërbimet për përpilimin e transkriptit janë në dispozicion.
6. Njoftoni departamentin përkatës për të siguruar transportin e deputetëve serb të Kuvendit.
7. Njoftoni shërbimin e sigurimit të ndërtesës së Kuvendit me listën e dëshmitarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë të dëgjimit publik.
8. Në bashkëpunim me zëdhënësin e Kuvendit shpërndani komunikatën për shtyp përfaqësuesve të mediave.
9. Përgatitni pllakëzat për tavolinë me emrat e pjesëmarrësve dhe anëtarëve të komisionit.

L. Gjërat që duhe të bëhen në ditën e mbajtjes së dëgjimit publik

1. Një orë para dëgjimit publik, shkoni në dhomën e caktuar dhe verifikoni a është e rregulluar sipas kërkesës, a janë përkthyesit të pranishëm si dhe a është paisja për përkthim e montuar dhe ne funksion.
2. Vendosni pllakëzat e emrave në tavolinë në atë mënyrë që anëtarët e komisionit të ulen në njëerën anë (përballë derës) ndërsa dëshmitarët në anën tjetër. Sekretari i komisionit (apo personi i caktuar nga ana e komisionit si "sekretar", mund të jetë qoftë anëtar i personelit ose i komisionit i cili do të sigurojë marrjen e shënimeve dhe do të ndihmojë me çfarëdo pyetje apo nevoja që paraqiten gjatë dëgjimit publik) duhet të ulet afër kryesuesit.
3. Keni në dispozicion pakot informative për mediat.
4. Bëni kopje shtesë dhe merrni me vete në dëgjimin publik gjërat e paraqitura si në vijim:
 - a. Projektligjin;
 - b. Listën e anëtarëve të komisionit;
 - c. Agjendën e dëgjimit publik;
 - d. Kopje shtesë të dëshmimeve të dëshmitarëve;

- e. Komunikatën për shtyp
- f. Letër të bardhë nëse u nevojitet deputetëve për shënime
5. Personeli duhet të caktojë një vend të veçantë për përfaqësuesit e mediave në dhomë. Mediave duhet t'u thuhet që të mos lëvizin me kamerat e tyre dhe të mos e pengojnë dëgjimin.
6. Sigurohuni që një anëtar i personelit të komisionit është i ulur afër kryesuesit dhe sekretarit përderisa një anëtar i personelit duhet të ulet afër derës në mënyrë që të mund t'i pret dëshmitarët dhe t'i drejtoj nëpër vendet e tyre si dhe t'i ofrojë publikut informata me shkrim.
7. Ofroni publikut udhëzime se ku duhet të ulen dhe si t'i parashtrojnë pyetjet e tyre nëse kanë ndonjë.

M. Gjërat që duhet të bëhen gjatë dëgjimit

1. Të merren shënime të detajuara gjatë dëgjimit, përfshirë këtu edhe një përmbledhje të asaj çka është thënë nga dëshmitari dhe pyetjet e parashtruara nga ana e anëtarëve të komisionit dhe përgjigjet vijuese.
2. Përkujtoni dëshmitarët se si duhet të shfrytëzohen pajisjet për përkthim dhe domosdoshmërinë për të përdorur mikrofonët për të siguruar që pajisjet për përkthim funksionojnë si duhet.

N. Gjërat që duhet të bëhen pas dëgjimit:

1. Shqyrtoni procesverbalin dhe transkriptin e dëgjimit.
2. Përpiloni një përmbledhje për anëtarët e komisionit të asaj çka është thënë nga secili dëshmitar.
3. Identifikoni të gjitha rekomandimet për amandamentet në projektligj dhe vendosni për amandamentet e mundshme nëpër kategori, përfshirë këtu edhe ndryshimet teknike, gjuhësore si dhe ato përmabjtësore.
4. Pasi që komisioni të takohet për të shqyrtuar dëshmitë nga dëgjimi publik, punoni së bashku me kryesuesin, zëvendës kryesuesin apo raportuesin për të përpiluar një raport me rekomandime për miratim nga komisioni.
5. Pasi që komisioni të ketë shqyrtuar raportin, bëni ndryshimet e nevojshme dhe fitoni miratimin përfundimtar nga ana e komisionit për raportin në fjalë.
6. Pasi që komisioni të ketë miratuar këtë raport, dërgoni raportin në Zyrën për Propozime dhe Parashtrësia dhe në komisionet kryesore.

SHTOJCA #1

MOSTËR PYETJESH NGA DËGJIMI PUBLIK MBI LIGJIN KUNDËR DISKRIMINIMIT DHE LIGJIT PËR BARAZI GJINORE

Më poshtë është paraqitur lista e pyetjeve e cila i dërgohet të gjithë dëshmitarëve të thirrur për të marrë pjesë në dëgjimin publik mbi Ligjin Kundër Diskriminimit dhe Ligjin për Barazi Gjinore. Qëllimi i këtyre pyetjeve është që prezentimet e dëshmitarëve të përqëndrohen në çështjet brengosëse të cilat komisioni i ka identifikuar. Duke përpiluar një listë të pyetjeve të përgjithshme, komisioni kërkon mendimet e dëshmitarëve në ato fusha të shqetësimit.

Për shkak se pyetjet në fjalë janë të përgjithshme dhe të shumta, duhet t'u shpjegohet dëshmitarëve se deklaratat e tyre duhet t'u përgjigjen vetëm atyre pyetjeve për të cilat ata ndjejnë se janë kompetent për t'u përgjigjur.

Këto pyetje megjithatë paraqesin udhëzime të cilat nuk janë detyruese qoftë për deklaratat e dëshmitarëve, qoftë për pyetjet gojore të parashtuara nga anëtarët e komisionit gjatë dëgjimit publik.

- 1. A do të informoni shkurtimisht komisionin mbi ekspertizën tuaj në lidhje me projekt ligjin kundër diskriminimit dhe projektligjin për barazi gjinore?*
- 2. A mbështetni qëllimin e përgjithshëm të projektligjit kundër diskriminimit apo projektligjit për barazi gjinore?*
- 3. A mendoni se projektligjet në fjalë mund të arrijnë qëllimin e paraparë në formën e vetë të tanishme?*
 - a. Projektligji kundër diskriminimit*
 - b. Projektligji për barazi gjinore*
- 4. A mendoni se projektligjet do të përballen apo do të krijojnë probleme praktike apo ligjore gjatë zbatimit të tyre?*
 - a. Projektligji kundër diskriminimit*
 - b. Projektligji për barazi gjinore*
- 5. A mendoni se projektligjet mund të zbatohen në mënyrë të duhur nga ana e institucioneve dhe nëpërmjet të sanksioneve të parashikuara ligjore?*
 - a. Projektligji kundër diskriminimit*
 - b. Projektligji për barazi gjinore*
- 6. Si përshtaten projektligjet në sistemin juridik në Kosovë? A shihni ndonjë konflikt me ligjet ekzistuese apo me pushtetin e rezervuar të PSSP-së?*
 - a. Projektligji kundër diskriminimit*
 - b. Projektligji për barazi gjinore*

7. *Sipas mendimit tuaj, si ndërlidhen ndërmjet veti në aspektin ligjor këto dy ligje? Sa e plotësojnë ato njëra tjetrën? A shihni probleme ndërmjet tyre gjatë zbatimit të tyre në praktikë?*
8. *A kanë projektligjet në bazë të mendimit tuaj ndonjë implikim për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës? Nëse po, sa janë shpenzimet në bazë të vlerësimeve tuaja?*
 - a. *Projektligji kundër diskriminimit*
 - b. *Projektligji për barazi gjinore*
9. *A ndikojnë projektligjet projektligjet në bazë të mendimit tuaj në të drejtat dhe interesat e komuniteteve në mënyrë negative?*
 - a. *Projektligji kundër diskriminimit*
 - b. *Projektligji për barazi gjinore*
10. *Cilat janë shqetësimet e juaja të posaçme mbi këto projektligje? Në këtë aspekt cilat amandamente kishit pasur dëshirë që komisioni t'i shqyrtojë?*
 - a. *Projektligji kundër diskriminimit*
 - b. *Projektligji për barazi gjinore*

MODELI I PYETJEVE NGA DËGJIMI PUBLIK I SIMULUAR MBI NJË LIGJ TË PARAMENDUAR PËR TATIMIN MBI PRONËN E PATUNDSHME

(I përdorur në trajnimin e anëtarëve të komisioneve të Kuvendeve komunale)

Konteksti

Më 6 qershor 2002 Kuvendi Komunal i Dardanisë miratoi Rregulloren mbi Tatimin në Pronën e Patundshme për komunë. Në kohën e miratimit të rregullores, ende nuk kishte ligj i cili do të rregullonte çështjen e vënies së tatimeve mbi pronën e patundshme. Për këtë arsye Kuvendi Komunal i Dardanisë është dashur të nxjerrë një rregullore të veten. Edhe pse, tatimi mbi pronën e patundshme nuk ishte shumë i lartë, prap se prapë qytetarët hezitonin që t'a paguajnë taksën. Kjo ndodhi për shumë faktorë. Ishte kohë e pasluftës dhe qytetarët ende ishin në fazën e shërimit nga fatkeqësitë e luftës. Ekonomia ishte shkatërruar dhe të ardhurat personale ishin të vogla. Në të vërtetë, ky ishte shkaktari kryesor pse komuna e kishte aprovuar një tatim të ulët. Me rregullore është përcaktuar që për pronën e patundshme private dhe industriale tatimi vjetor është 0.02 % e vlerës së përgjithshme të pronës, ndërsa për pronën komerciale tatimi vjetor është 0.03% e vlerës së përgjithshme të pronës.

Në maj të vitit 2003, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin mbi Tatimin në Pronën e Patundshme. Ky ligj do të implementohet në tërë Kosovën dhe të gjitha rregulloret komunale do të duhet të jenë në përputhje me kornizën parashikuar me ligj të Kuvendit të Kosovës.

Ligji përcakton kufijë tjerë. Sipas ligjit të ri tatimi mbi pronën e patundshme duhet të jetë nga 0.05% gjer në 1% e vlerës së përgjithshme të pronës. Përqindja e saktë e tatimit do të vendoset nga kuvendi komunal. Megjithatë përqindja e tatimit nuk duhet të jetë nën 0.05% dhe mbi 1% e vlerës së përgjithshme të pronës.

Është shumë e qartë që Kuvendi Komunal i Dardanisë duhet të ndryshojë rregulloren në mënyrë që jetë në pajtim me kufizimet tjera të parashikuara me legjisllacionin e ri të nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës. Definitivisht, tarifa e tatimit mbi pronën e patundshme duhet të rritet së paku për 0.03%, sepse tarifa minimale është 0.05%.

Ekzistojnë mendime të ndryshme lidhur me tarifën e tatimit mbi pronën e patundshme. Ka të atillë, që mendojnë se tatimi është shumë i vogël dhe që duhet shfrytëzuar rasti për ndryshimin e tarifës, në pajtim me ligjin, që tarifa të rritet në masë më të madhe për qëllime të programeve specifike. Në anën tjetër, disa të tjerë mendojnë që për shkak të situatës shumë të rëndë ekonomike qytetarët nuk do të jenë në gjendje të paguajnë tatim më të lartë.

Komisioni për politikë dhe financa duhet t'i rekomandojë Kuvendit se cila duhet të jetë tarifa e tatimit. Komisioni qëndron para një dileme. Ata mund të rekomandojnë tatim më të ulët, gjë që do t'i mbante tatimpaguesit të kënaqur mirëpo kjo do të thotë më pak shërbime duhet t'u ofrohen qytetarëve, ose të rekomandojnë tatim më të lartë gjë që do t'i mundësonte qeverisë lokale të ofrojë më shumë shërbime qytetarëve dhe të zbatojnë projekte tjera zhvillimore. Mundësia e ofrimit të shërbimeve më të mira dhe zbatimi i projekteve zhvillimore do të rezultonte në mundësi të reja për qytetarët e Dardanisë.

Komisioni dëshiron të vendos për rekomandimin më të mirë për qytetarët e Dardanisë. Për atë qëllim, komisioni ka vendosur të mbajë dëgjimin publik lidhur me këtë çështje. Ata do të ftojë përfaqësues nga departamenti ekzekutiv, ekspertë të pavarur, përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit, organizata joqeveritare dhe grupe specifike të qytetarëve të cilët preken më së shumti nga çështja e cila po shqyrtohet.

Sot, në dëgjimin publik, janë ftuar pesë dëshmitarë:

1. Drejtori i drejtorisë për ekonomi dhe financa
2. Përfaqësuesi i shoqatës së pensionistëve të Dardanisë
3. Përfaqësuesi i OJQ-së "Gratë për Gratë", organizatë kjo e cila mbështetë fuqizimin e gruas, me fokus të veçantë në gratë mbajtëse të familjes.
4. Përfaqësuesi i shoqatës së bujqëve të Dardanisë.
5. Përfaqësuesi i i OJQ-së "Vizioni i Rinisë", organizatë rinore me seli në Dardani.

Mostër e pyetjeve

Pyetjet e mundshme për Zyrтарin Ekzekutiv:

1. A e dini se sa do të jetë shuma e parave të grumbulluara nga këto tatime?
2. Sa ka qenë ekzekutivi efikas në grumbullimin e tatimeve deri tani? Cilat kanë qenë pengesat kryesore me të cilat jeni përballur gjatë grumbullimit të tatimeve?
3. Nëse jeni ballafaquar me probleme gjatë grumbullimit të tatimeve të ulëta, pse mendoni që qeveria do të jetë në gjendje që të grumbullojë tatimet e larta në mënyrë më efikase?
4. A keni bërë ndonjë hulumtim para se të propozoni shkallën e tatimeve? Nëse po, cilat janë gjetjet tuaja?
5. Cila është shuma e të ardhurave mesatare për një familje?
6. A keni kontaktuar me Qendrën për Punë Sociale për të kërkuar shënimet për familjet të cilat gjenden në asistencë sociale?
7. Cilat janë planet e ekzekutivit lidhur me ndarjen e mjeteve të grumbulluara nga tatime në pronën e patundshme? Cilat janë prioritetet? Kush janë përfituesit?
8. A planifikoni të rritni pagën për këshilltarët e Kuvendit Komunal së shpejti?

Pyetjet e mundshme për Shoqatën e Pensionistëve:

1. Ju na treguat për çiftet e pensionistëve të cilët jetojnë të vetmuar dhe situatën e vështirë në të cilën jetojnë ata. Unë jam i interesuar të di numrat e saktë.
2. A mundet shoqata e juaj të na ofrojë informata mbi numrin e saktë dhe vendndodhjen e kësaj kategorie të cenuar të popullatës?
3. A mendoni që ka pensionistë të cilët jetojnë në familjet e zgjeruara, me fëmijët e tyre të punësuar dhe të cilët do të mund të paguanin tatimet?

Pyetjet e mundshme për Shoqatën e Bujqëve:

1. Cilat janë, në të vërtetë, mënyrat me të cilat Kuvendi Komunal do të mund t'ju mbështeste më së miri?
2. Çfarë prodhime bujqësore importohen e që do të mund të prodhoheshin në vend? A ka ndonjë projekt të mundshëm që do t'ju mundësonte të prodhoni më shumë prodhime bujqësore këtu?
3. A mendoni që nëse fondet do të mund të shfrytëzoheshin për ndërtimin/riparimin e rrugëve, në mënyrë që ju të mund ta transportoni prodhimet tuaja në treg?

Pyetjet e mundshme për OJQnë "Vizioni i Rinisë":

1. Sa mendoni ju që çështjet rinore kanë prioritet në krahasim me çështjet e pensionistëve dhe grave mbajtëse të familjes?
2. Nëse do të duheshit të zgjedhni për implementimin e vetëm njërit nga projektet që i përmendët, cili do të ishte ai projekt?
3. A keni ndonjë ide se sa do t'i kushtonin projektet tuaja komunës

Pyetjet e mundshme për OJQ-në "Gratë për Gratë":

A mund të jeni më të saktë se çfarë lloj trajnimi mendoni që ju nevojitet grave mbajtëse të familjes?

SHTOJCA #2:

MOSTRA E ORARIT KOHOR PËR PËRGATITJEN E DËGJIMEVE PUBLIKE (përfshirë mostrën e kalendarit)

10 DITË PARA DËGJIMIT:

- Komisioni cakton datën dhe kohën e dëgjimit publik
- Rregullon sallën ku duhet të mbahet dëgjimi
- Konfirmoni listën e dëshmitarëve dhe **pyetjet** për komisionin (apo kryesuesin e komisionit në mungesë të komisionit)

9 DITË PARA DËGJIMIT:

- Përgatitni dhe dërgoni thirrjet dëshmitarëve
- Siguroni pajisjet dhe personelin për përkthim dhe transkript.

8 DITË PARA DËGJIMIT:

- Përgatitni një komunikatë për shtyp dhe **merret miratimi i kryesuesit** dhe mëpastaj i dorëzohet zëdhënësit të Kuvendit për miratim nga ana e tij.

6-7 DITË PARA DËGJIMIT PUBLIK:

- Përgatitet agenda dhe i dorëzohet kryesuesit për miratim.
- Përgatitet libër informativ dhe shpërndahet për të gjithë anëtarët e komisionit.
- Konfirmoni pjesëmarrjen e dëshmitarëve të thirrur dhe anëtarëve të komisionit.

4-5 DITË PARA DËGJIMIT PUBLIK:

- I dërgohet mediave komunikata e miratuar për shtyp.

3 DITË PARA DËGJIMIT PUBLIK:

- Konfirmohet nëse të gjitha çështjet logjistike janë të gatshme për dëgjim.

2 DITË PARA DËGJIMIT PUBLIK:

- Përgatitet pakoja për shtyp
- Mbledhet lista e dëshmitarëve dhe fotokopjohen dëshmitë me shkrim.

1 DITË PARA DËGJIMIT PUBLIK:

- U jepni dëshmitë me shkrim anëtarëve të komisionit

DITËN E DËGJIMIT PUBLIK:

- Ofroni paket për shtyp përfaqësuesve të mediave të pranishme në dëgjimin publik
- Siguroni kopjet shtesë të materialeve që janë të gatshme

PAS DËGJIMIT:

- Shqyrtoni transkriptin e dëgjimit.
- Përmbledhni dëshmitë e dëgjimit dhe përpiloni një listë të amandamenteve të rekomanduara në projektligj.
- Bazuar në rekomandimet e komisionit, përpiloni një draft raport të rekomandimeve në lidhje me ligjin.
- Finalizoni raportin e rekomandimeve dhe merrni miratimin përfundimtar të komisionit.
- Shpërndani raportin me rekomandime në Zyrën për Propozime dhe Parashpresa të Kuvendit dhe komisioneve kryesore.

